



Projekti "Promovimi i shërbimeve të turizmit rural dhe infrastrukturës në rajonin e Shalës", është një projekt i financuar nga BE, dhe zbatohet nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Objektiva e përgjithshme e këtij projekti është krijimi i kushteve për turizëm rural dhe zhvillimin e bizneseve familjare në rajonin e Shalës. Si objektiva specifike: zhvillimi i shtigjeve të ecjes në zonat e maleve të larta, krijimi i bizneseve fillestare për turizëm dhe mbështetja e atyre ekzistuese, fuqizimi ekonomik i ekonomive familjare, rritja e sasisë dhe cilësisë së prodhimit të ushqimit tradicional, avansimi i shërbimeve turistike në zonat rurale, promovimi i përdorimit të energjisë alternative dhe prodhimi i tij.

IADK kërkon kandidat të kualifikuar pozitën:

Titulli i vendit të punës: **Inxhinier**
Vendi i punës: **Sfaraçak i Ulët, Vushtrri**
Kohëzgjatja: **4 muaj nga nënshkrimi i kontratës (01.08 - 30.11.2014)**

Përshkrimi i punës:

Inxhinieri do të jetë nën përgjegjësinë e Drejtorit Ekzekutiv dhe Projekt Menaxherit. Ai/ajo do të bëjë koordinimin e punëve me palet në interes.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Mbikqyrja e planit për odat pritëse tradicionale
- Të prezantojë projektin tek palët e interesit dhe të bashkëpunojë ngushtë me Komunitatet ku do të shtrihet projekti
- Të bëjë shpërndarjen e të mirave tek përfitesit
- Të përgatit raporte dhe monitorim për secilin aktivitet të punëve
- Përgatit dhe azhurnon materialet e dukshmërisë
- Bën koordinimin e punëve në kuadër të projektit
- Përcjellë dhe përgatit të gjitha misionet me ekspertë për ekspertiza të ndryshme sipas kërkesave të projektit
- Përkrah prokurimin në dizajnimin e planit dhe kritereve për zgjedhje të kompanive që angazhohen në projekt
- Të jetë efikas në implementimin e të gjitha aktiviteteve të lartcekura në kuadër të projektit
- Kryen edhe punë tjera që do të kërkohen nga Drejtori Ekzekutiv i IADK-së

Kualifikimet dhe kompetencat kryesore

- Diplomë univeristare (Arkitekturë, Ndërtimtari)
- Njohuri të avancuara dhe përvojë në komunikim me audiencë dhe media
- Njohuri në përdorim të kompjuterit Windos, Excel dhe Power Point Archicad dhe mirëmbajtjen e web-it
- Përvojë administrative dhe njohuri në menaxhim me resurse njerëzore dhe legjislacion
- Përvojë të ngjashme pune me zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve në ndërtimtari dhe arkitekturë tradicionale së paku 3 vite
- Aftësi të mira në të shkruar në të tri gjuhët shqip, anglisht dhe serbisht
- Të jetë i gatshëm të punojë nën presion
- Të posedojë patentë shoferin



Ju lutemi të dërgoni CV-në tuaj me letrën e interesit në zyret e IADK- së deri më datën 24.07.2014 ora 16:00 në këtë adresë: **Sfaraçak i Ulët p.n, Vushtrri.**

Personi kontaktues: Ariana Selmani – Zyrtare për Prokurim/Logjistikë&Administratë
Nr.tel. +381(0) 28 536 726. Aplikacionet mund të dërgohen edhe në këtë e-mail adresë:
prokurimi@iadc.org.

Pjesëtarët e minoriteteve dhe femrat inkurajohen të konkurojnë. Vetëm kandidatët nga lista e ngushtë do të ftohen në intervistë.

Vetëm aplikacionet që dorëzohen në **IADK deri më 24 Korrik 2014 do të merren në konsiderim.**